



Tekst zyrtar \_\_\_\_\_ siç është ndryshuar dhe plotësuar me datë 25.06.2009

*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,*

Në bazë të nenit 7.4, 8, 9 dhe 64.2 pika (a) dhe (b), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-073 dhe nenit 12.1, 20 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës Nr.03/L-072, nxjerr:

**RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 02/2008**  
**PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE E KONFIRMIMIT TË LISTËS SË**  
**VOTUESVE**

Neni 1  
Dispozitat e Përgjithshme

1.1 Për qëllime të kësaj Rregulle, me Listë të Votuesve (LV) nënkuptohet lista e të gjithë votuesve me të drejtë vote, siç përcaktohet me nenin 7.1 dhe nenin 7.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

1.2 Lista e Votuesve do të përmbajë:

(a) të gjithë votuesit me zotësi juridike që votojnë në Kosovë të renditur sipas alfabetit dhe komunës. Informatat personale që do të sigurohen për secilin votues janë emri, mbiemri, data e lindjes së tij/saj, numri personal, adresa dhe qendra e votimit ku ai/ajo është caktuar të votojë; dhe

(b) të gjithë votuesit me zotësi juridike që votojnë nga jashtë Kosova të renditur sipas alfabetit. Informatat personale që do të sigurohen për secilin votues janë emri, mbiemri, data e lindjes së tij/saj numri personal dhe adresa.

1.3 Me Periudhën e Kundërshtimit dhe të Konfirmimit nënkuptohet periudha kohore në mes 54 ditëve dhe 40 ditëve para Ditës së Zgjedhjeve e shpallur nga Presidenti i Kosovës gjatë së cilës votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë pasaktësitë dhe lëshimet në LV në pajtim me procedurat e themeluara me këtë rregull zgjedhore, dhe të gjitha dispozitat ligjore në zbatim.

1.4 Para se të filloj Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit, KQZ Sekretariati (KQZ S) do të vë LV në dispozicion në zyrat e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) në secilën komunë. KKZ -të, mund të caktojnë lokacion shtesë për ta vendosë LV, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave, kur është e nevojshme për ti ju dhanë votuesve më shumë mundësi, që të kenë qasje në LV, në komunën e tyre. .

1.5 Para ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja do ta Certifikoj LV e cila është e themeluar në pajtim me dispozitat ligjore në zbatim, pasi që publiku ka pas mundësi t'i sfidojë pasaktësitë dhe mangësitë.

Neni 2  
Procesi i Kundërshtimit dhe Konfirmimit

2.1 Çdo votues me zotësi juridike, siç është e specifikuar në nenin 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mund të ketë qasje dhe të sfidojë LV, ose çdo pasaktësi ose mangësi në LV, gjatë Periudhës së Kundërshtimit dhe të Konfirmimit, çdo ditë pune nga e Hëna deri të Premten, prej orës 09:00 deri 12:00 dhe prej orës 13:00 deri 16:00 në Hapësirat e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në secilën komunë.

2.2 Vëzhguesit e Akredituar të Zgjedhjeve mund të vëzhgojnë Periudhën e Kundërshtimit dhe Konfirmimit në të gjitha lokacionet ku LV është vënë në dispozicion për shikim.

2.3 Çdo votues me zotësi juridike mund të shqyrtoj ose të sfidojë LV, ashtu siç përcaktohet në nenin 2.1, me kusht që ai/ajo të identifikohet siç duhet para KKZ-së, duke paraqitur njërin nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- a) letërnjoftimin ID e vlefshëm
- b) dokumenti i udhëtimit i vlefshëm
- c) pasaportë i vlefshëm
- d) patentë shoferin i vlefshëm

2.4) Çdo votues me zotësi juridike i regjistruar suksesshëm për programin e Votimit Jashtë Kosovës, mund ta shqyrtoj LV-në, në web-faqen zyrtare të KQZ-së, siç parashihet në nenin 2.1 të kësaj Rregulle. Votuesi i regjistruar suksesshëm për Votimin Jashtë Kosovës mund ta sfidojë LV, duke paraqitur ai/ajo në mënyrë të rregullt veten, me njërin nga dokumentet e identifikimit që pasojnë:

- a) dokumentin valid me foto,
- b) dëftesën e regjistrimit si votues Jashtë Kosovës

2.5. Një person, i cili e identifikon veten me një dokument identifikimi siç parashihet në nenin 2.3, dhe 2.4 mund të kërkojë korrigjim ligjorë te organet kompetente, në pajtueshmëri me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nëse ai/ajo konstaton se emri i tij/saj nuk gjendet në LV

2.6 Personi që dëshiron të kundërshtoj një emër, për të cilin ai/ajo mendon se nuk duhet të jetë në LV, mund të kërkojë korrigjim ligjorë te organet kompetente, në pajtueshmëri me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës të Kosovës.

Neni 3  
Shpërndarja e Kopjeve të Listave të Votuesve

3.1 Sekretariati i KQZ-së i siguron LV çdo personi kontaktues të secilit subjekt politik të certifikuar, para fillimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit.

3.2 Çdo përdorim i LV nga subjektet politike të certifikuara që është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes të subjekteve politike dhe përkrahësve të tyre, ose ndonjë dispozitë tjetër ligjore në fuqi, paraqet shkelje të këtyre dispozitave

3.3 Sipas kërkesës individuale të vëzhguesit të akredituar të zgjedhjeve, KQZ/SKQZ ose KKZ të do të sigurojë kopje të LV gjatë periudhës së zgjedhjeve.

Neni 4  
Procesi i Gjykimit

\_Në rast se personi kërkon korrigjim ligjor në pajtim me nenin 2.5 dhe 2.6 të kësaj rregulle, dhe organi kompetent brenda autoritetit të tij vendosë që kërkesa e personit është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi, ka autorizim të urdhërojë KQZ-në të ndërmarrë veprime korrigjuese.

Neni 5  
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregull zgjedhore hyn në fuqi më 25.06.2009.

**Nesrin Lushta**

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



---